



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:050259

Datë: 07.03.2022

Numri i dokumentit: 02784466

C.nr. 112/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Shemsedin Haxhiaj në çështjen juridike kontestimore, të paditësit A. (N.) Z. nga fsh. Sh. Komuna Istog, i përfaqësuar nga Sh. G. avokat nga P. rr. “.....” nr.. , kundër të paditurve Sh. Z., B. Z. dhe I. Z. të gjithë nga fsh. Sh. Komuna Istog, nga baza juridike: pengim posedimi, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij si dhe te paditurve, në seancën e shqyrtimit kryesor, të datë 21.02.2022, bie këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesëpadia e paditësit A. Z. nga fsh. Sh. K Istog me të cilën ka kërkuar që te vërtetohet se të paditurit Sh. B. dhe I. Z. që të gjithë nga fsh. Sh. K Istog me dt. 28.02.2021 në ora 10:30 kanë penguar paditësin në posedimin e qetë dhe te fundit të truallit të tij në atë mënyrë që duke ia larguar ekskavatorin se bashku me shofer, respektivisht duke u ngjitur mbi ekskavator dhe duke ia pamundësuar që i njëjti të filloj më përgatitjen e tokës bujqësorë për implementimin e një granti përfitues nga MBPZHR në tërësinë e parcelave që përfshinë ngastrat 47-2, 47-1,47,3,47-4 si dhe një pjesë të ngastrës 52-6 dhe një pjesë të ngastrës 50-6, në sipërfaqe të gjithmbarshme prej 53313 m2 ZK Sh. Komuna Istog, të cilat evidentohen në emër të paditësit A. Z..
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij më padi si dhe në precizimin e saj ne parashtresën e datës 17.01.2021, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka kërkuar që të vërtetohet se të paditurit Sh. B. dhe I. Z. që të gjithë nga fsh. Sh. K Istog me dt. 28.02.2021 në ora 10:30 kanë penguar paditësin në posedimin e qetë dhe te fundit të truallit të tij në atë mënyrë që duke ia larguar ekskavatorin se bashku me shofer, respektivisht duke u ngjitur mbi ekskavator dhe duke ia pamundësuar që i njëjti të filloj më përgatitjen e tokës bujqësorë për implementimin e një granti përfitues nga MBPZHR në tërësinë e parcelave që përfshinë ngastrat 47-2 me kulturë kullosë klasa4, ngastra 47-1 me kulturë tokë pyjore mal klasa e 3, ngastra 47-3 me kulturë tokë bujqësore livadh i klasës 5, ngastra 47-4 tokë bujqësore kullosë e klasës se 4 si dhe një pjesë të ngastrës 52-6 me kulturë tokë bujqësore livadh i klasës 5 dhe një pjesë të ngastrës 50-6 me kulturë arë e klasës 5 të cilat evidentohen në emër të paditësit A. Z. në sipërfaqe të gjithmbarshme prej 53313 m2 ZK Sh. K Istog.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbes pranë padisë , parashtresës

mbi precizimin e kërkesëpadisë te dorëzuar në këtë gjykatë me dt.17.01.2022, pas administrimit te provave te propozuara siç është certifikata e pronësisë me nr,648/2020 me te cilën vërtetohet se paditësi është pronar i sipërfaqes prej 11 hektarëve, 51 ari dhe 61 m², kontrata e shitblerjes e Noterizuar LRP.nr.088/20 nr.ref. 088/20, njoftimi Agjencisë mbi zhvillimin e Bujqësisë nr. 07/04 dt.10.11.2020, raporti i policisë dt.28.02.2021, Aktakuza nr., PP.II.nr. 468/21 dt.16.03.2021, kontrata mbi dhënien me qira te tokës, dt.30.07.2012, e.02.2016 dhe 30.07.2017 ekspertiza e ekspertit te gjeodezisë, dëgjimi i paditësit në cilësi te dëshmitarit A. Z. dhe G. Z. e po ashtu e dhe letëinformimin nga Ministra e Bujqësisë e dt.19.08.2021 ,e nr. reference 07/4 , 5435, me te cilin i njëjti është dëmtuar 5000 Euro si shak i mos impelmentimit te grantit Bujqësor është vërtetuar se te paditurit Sh. B. e I. Z. me dt. 28.02.2021 rreth orës 10.30 min, në fsh. Sh. K- Istog e kanë penguar paditësin në posedim te fundit te qetë paditësin A. Z. në atë mënyrë qe duke ia larguar ekskavatorin se bashku me shofer, duke u ngjitur me ekskavator dhe duke e pa mundësuar qe i njëjti te filloi me përgatiten e tokës bujqësor për implementim te një granti përfitues nga Ministria e Bujqësisë në tersin e parcellave nr. ngastrat 47-1, 47-2. 47-3. 47-4.52-6 dhe 50-6.me një sip. Prej 5 hektarve 33 ari e 13m². Të detyrohen te paditurit qe brenda 15 ditësh nga dita pranimit te këtij aktvendimi t'ia kthejnë paditësit A. Z. në posedim ngastrat e cekura si me lartë sipas certifikatës pronësore me nr, 3569/2021 në te ardhmen te përmbahen nga pengimi i tillë apo i ngjashëm nën kërcenim te përmbarimit te detyrueshëm, shpenzimet procedurale i ka kërkuar sipas listës së shpenzimeve në shumën prej 1,123.80 euro.

Të paditurit që nga fillimi i procedurës kontestimore kanë kontestuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, ndërsa në fjalën përfundimtare, i padituri Sh. ka deklaruar se e kundërshtojmë në tersi kërkesëpadinë nga se e njëjta është në tersi e pa bazuar, i propozoi gjykatës qe te njëjtën ta refuzoi në teri siç deklarova edhe me lartë në tersi ngastrat janë punuar nga ana e jonë dhe migja asnjëherë nuk i ka punuar edhe pse nuk a ka pas në posedim atë ditë ka filluar ti punoi nga se te njëjtat probleme i ka pasur edhe për gjallë te prindit tonë. Dhe përveç këtyre te cilat i potencova kërkojmë drejtësi nga ana e gjykatës dhe asgjë me shumë. Edhe dy te paditurit tjerë deklarojnë njëzëri se e mbështesim fjalën përfundimtare te dhënë nga vëllai dhe nuk kanë diçka tjetër për te shtuar.

Gjykata në këtë çështje juridiko - kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejt të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve, ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat: kontrata mbi dhënien me qira te tokës bujqësore e dt.20.03.2017, aktakuza PP/II.nr.468/2021 dt.16.03.2021, kontrata për dhënien e tokës me qira e dt.01.02.2016, kontrata mbi dhënien me qira te patundshmërisë e dt.30.07.2012, certifikatë pronësore me nr. 648/21 dt.09.03.2021, kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë me nr. LRP.nr., 088/20, Ref.088/20, informata e dhënë nga Agjencia për Zhvillimin pranë Ministrin e Bujqësisë e dt.10.11.2020, oferta e dhënë nga NPSH “.....” fsh.K. , K-Istog, raporti i ekspertit gjeodetit dt/07.10.2021, se bashku me skicën e terrenit, certifikatën pronësore 8 foto te vendit te ngjarjes, letër informimi lëshuar nga MBPZHR- Agjencia e Zhvillimit te Bujqësisë.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku e në lidhmëni në njëra tjetrën e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore arriti në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e bazuar, pasi që vërtetoi këtë gjendje faktike :

Nga kontrata mbi dhënien me qira të paluajtshmërisë (tokës bujqësore) e lidhur me dt. 30.07.2012 në mes qiradhënësit Z. D. nga fsh. Sh. K-Istog dhe qiramarrësit A. Z. po nga fsh. Sh. Komuna Istog u vërtetua se qiradhënësi ia jep me qira qiramarrësit tokën e vet e cila gjendet në fsh. Sh. KK Istog sipas fletë posedueses nr.9 ZK Sh. e qe evidentohet si ngastër kadastraëe me nr. 47, 49, 52 me sipërfaqe prej 6.5 ha me çmim prej 200 Euro, e cila është tokë bujqësore.

Nga kontrata mbi dhënien me qere të tokës bujqësore te dt. 01.02.2016 vërtetohet se qiradhënësi Z. D. nga fsh. Sh. K Istog i jem me qira qiramarrësit A. Z. po nga fsh. Sh. parcelën e tokës bujqësore e cila gjendet në fsh.Sh. K Istog sipas fletës poseduese 1312 në ngastrën 55-1.

Nga kontrata mbi dhënien me qira të tokës bujqësore te datës 20.03.2017 u vërtetua se qiradhënësi Z. ia jep me qere qiramarrësit A. Z. paluajtshmërinë 1312 ZK Sh. ngastra nr. 50-1 në sipërfaqe prej 3 ha e 40 ari ashtu qe çmimi i qerasë 100 euro për hektar gjegjësisht 340 euro për tërë sipërfaqen, e cila paluajtshmëri do te mbillet dhe shfrytëzohet për kultura bujqësore qe i konvenojnë qiramarrësit.

Nga kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë me nr. LRP.nr., 088/20, Ref.088/20 e lidhur mes palëve Z.(R.) Gj. , Gj. (R.) Gj. dhe S. F. lindur Gj. si shitës dhe A. (N.)Z. si blerës u vërtetua se palët kanë arritur marrëveshje për shit-blerjen e paluatshmërisë njësia kadastrale P-708060548 me ngastrat kadastrale nr. 47-1, 47-2, 47-3, 47-4, 49-3, 50-6, 52-1 dhe 52-6 ZK Sh. me çmimin dhe kushtet e shitjes si në kontratë.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata në cilësi të provës materiale ka nxjerrë ekspertizën e ekspertit gjeodet B. G. të datës 07.10.2021, i cili e ka bërë identifikimin e parcelave kadastrale si tërësi-kompleks parcelave 47-3, 47-4, 50-6, 52-6 ku pas matjes konstatoj se brenda këtij kompleksi janë edhe parcelat 47-1, 47-2 të cilat në terren shfrytëzohen si të tilla dhe qe evidentohen në pronësi të po paditësit. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 47-1 me sipërfaqe te tërësishme prej 13594m2 shtrihet/ndodhet ne ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë mal i klasës 3. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 47-2 me sipërfaqe te tërësishme prej 7430 m3 shtrihet/ndodhet në ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë kullosë e klasës 4. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 47-3 me sipërfaqe te tërësishme prej 2792 m2 shtrihet/ndodhet në ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë me kulturë livadh i klasës 5. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 47-4 me sip. Të tërësishme prej 8493m2 shtrihet /ndodhet në ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë me kulturë kullosë e klasës 4. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 50-6 me sip. Të tërësishme prej 30472m2 shtrihet /ndodhet në ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë me kulturë arë e klasës 5. Parcela kadastrale me nr. të njësisë 52-6 me sip. Të tërësishme prej 37668m2 shtrihet /ndodhet në ZK Sh. vendi i quajtur “.....” me kulturë me kulturë livadh i klasës 5. Akti i pengim posedimit pretendohet te jetë kryer në hapësirë-sipërfaqen A me shrafure ngjyrë të gjelbert e cila kap sipërfaqe prej 5.33.12 ha dhe atë sipas skicës së matjes me pika detale me nr. nga 1 deri tek 32. Kjo hapësirë përbenë parcelat 47-1, 47-2, 47-3, 47-4 si dhe pjesë të parcelave 50-6, 52-6 të cilat sipas elaboratit kadastral evidentohen në pronësi të paditësit. Në anën veriore te pjesës A (pjesa ku po pretendohet qe po pengohet në posedim) nga pika 1 deri në pikën 2 gjendet shtegu për rrugën fushore, me gjerësi 4m duke vazhduar në drejtim te perëndimit deri tek pika 3 dhe 4 me gjatësi prej 84.74m. Përgjatë kësaj ane ne terren është i vendosur gardh natyror me hunjtë druri. Pastaj nga pika 4 deri në pikën 11 (përgjatë pikave thyerëse 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11) në anën perëndimore të pjesës pretenduese gjenden rrethojat me tela rrjetë dhe shtylla betoni me gjatësi sipas skicës së matjes. Në anën jugore të pjesës pretenduese nuk ka kufij të fortë faktik përpos megjes natyrore me drunjte të ndryshëm-mal nga pika detale nr. 12 deri në pikën 18 (përgjatë pikave thyerëse 13, 14, 15, 16, 17) me gjatësi sipas skicës se matjes. Përgjatë kësaj gjatësie kufizohet me parcelën 15-0 e cila evidentohet në pronësi të D. Gj. dhe parcelën 52-9 qe evidentohet në pronësi të Z. Gj. . Pastaj në anën Jug-Lindore kufizohet me parcelën 37-1 qe evidentohet në pronësi të K. Z. nga pika e detalit 18 deri në pikën 20 është mëgje natyrore-mal ndërsa nga pika e detalit 20 deri në pikën 23 është kufij natyror mes dy tokave punuese-arave. Në anën lindore kufizohet me parcelën 36-0 e cila evidentohet në pronësi te N. Z. nga pika e detalit nr. 23 deri në pikën 26 me gjatësi sipas skicës së matjes. Përgjatë kësaj ane ne teren ka mëgje natyrore me drunjte dhe shkurre te ndryshme. Në anën veri-lindore kufizohet me pjesën e parcelës 50-6 qe evidentohet në pronësi të paditësit, respektivisht nga pika e detalit 26 deri në pikën 27 ka kufij faktik natyror mëgje e

arës me livadhin. Pastaj vazhdon në drejtim të veriut nga pika e detalit 27 deri në pikën 1 përgjatë pikave thyese 28, 29, 30, 31, 32. Përgjatë kësaj ane ne teren ka kufij faktik me drunjë dhe shkurre të ndryshme. Shfrytëzimi aktual i kësaj pjese pretenduese-kontestuese është livadh, mal dhe një pjesë arë e punueshme. Pjesa tjetër e parcelave 52-6 me shkronjë B dhe pjesa e parcelës 50-6 me shkronjë C sipas pretendimeve të palës nuk janë të pengueshme. Pjesa B është tokë bujqësore e mbjelle me fidanë arë. Ndërsa pjesa tjetër është me shfrytëzim aktual livadh.

Me qëllim të vërtetimit sa me të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor është bërë edhe procedimi i palëve, pala paditëse A. Z. i cili ka deklaruar: me dt. 28.02.2021 kam pasur qe t'ia filloj qe nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3 ha e 10 ari ku për këtë sipërfaqe kam qene përfitues i një grandit për mbjellje të fidanëve arrë, dhe me të shkuar me bageristin dhe me të filluar nga ana e bageristit tre të paditurit kane shkuar menjëherë dhe iu kane hedhur sipër bagerit ne atë moment bageristi është frikësuar dhe ka ndërprerë punën dhe janë kthyer prapa dhe menjëherë është njoftuar policia dhe kem kërkuar qe te jene prezent ne vazhdimin e punimeve por te njëjtit kane thënë se vetëm nëse keni probleme ne munde te vijmë ne te kundërtën nuk kane dashur te vine, dhe aty pronari i firmës kontraktuese i ka ngarkuar bagerat me kamion dhe unë i kam lutur te mos largohen se po vije policia edhe përkundër kësaj ai është kthyer për Pejë dhe me pastaj ka ardh policia dhe nen prezencën e tyre jemi rrahur, dhe pas dy muajve kam tentuar përmes një firme tjetër te cilit ia kam dhënë numrin e te paditurit Sh. qe te kontaktoj duke dhënë mundësin qe te vazhdoj punimet por i njëjti i ka thënë se nëse me ndegjon mua nuk i vazhdon punimet, me pastaj kam kontaktuar një kompani tjetër nga D. i cili ka pranuar dhe i kam përfunduar punimet. Dhe te paditurit me nuk me kane penguar ne kryerjen e punëve sa i përket pemishtes e për te cilën kam qene përfitues i grandit dhe e gjitha ka qene e caktuar me kohë, por me pastaj te njëjtit me kane penguar për ngastrat tjera malin, livadhin etj. Edhe me herët e kam punuar gjithë sipërfaqen. Sipërfaqen prej 11 ha e kam blere ne vitin 2020, e te cilat janë ng.52/1, 47/1, 47/2, 47/3, 47/4, 52/6, 50/6 pjesërisht. Të paditurit i kam njoftuar por kane thënë se njëherë le te blenë baci A. e me pastaj ne do te blejmë prej tij. Grandi përfitues nuk është mbushur ne tersi për shkak se punimet kane filluar me vonesë dhe jemi dënuar me gjobë prej 5000 euro nga Ministria e Bujqësisë për shkak te mosrespektimit te afateve për kryerjen e punimeve sipas grandit. Ngastrat kontestuese i kemi blerë prej Gj. Gj., Z. Gj. dhe S. motra e tyre me kontratë e cila ka qenë e vërtetuar te noteri si dhe ka qenë edhe vlerësimi i patundshmërive. Sipërfaqen tjetër e cila është jashtë rrethojave te pemishtes e cila përbëhet me kulture kullose dhe nga përfundimi me kulture male i kam shfrytëzuar vetëm si kullosë ndërsa për ng.47/4 ia kam dhënë te paditurve por me pastaj ata me kane thënë se nuk kem pune me ty por vetëm me serbet dhe e kane shfrytëzuar pa me pyetur mua fare, dhe për këtë pjese me kane penguar kah viti 2018 ku dhe serbet nuk kane pasur mundësi qe te hynë për shkak se këta i kane shkaktua telashe. Pra nga gardhi i cili gjendet ne teren e tutje te tret te paditurit me kane thënë se nuk guxon te futesh me tutje për te punuar tokën. Pjesa e nga.50/6 është ne sipërfaqe prej 3 ha 76 ari ndërsa e mbjellë me fidanë arë është 3 ha edhe pse sipas projektit ka qene 3 ha e 10 ari, me dt.28.02.2021 siç deklarova edhe me larte për afërsisht rreth orës 10 apo 11 me rastin e kryerjes se punimeve ne këtë pjese te ngastrës siç deklarova edhe me larte te tre te paditurit shkojnë gjithkrah se bashku dhe atë dite qe te tret iu kanë hedhur mbi bager duke mos lejuar kryerjen e punimeve. Është me rendësi te ceket se policia i kanë thënë te paditurve se nëse edhe një padi parashtrohet nga unë ata do te kenë punën keq dhe me nuk kane penguar dhe pas 2 apo 3 muajve kur kam dërguar një bashkëvendës ta kosit nuk e kane lejuar.

I padituri Sh. Z. gjatë shqyrtimit kryesor i proceduar në cilësi të dëshmitarit ka deklaruar: se nuk kam qenë bashkë me vëllezërit kur këta kanë shkuar me herët, unë kam qenë brenda në shtëpi, këta kanë qenë duke punuar dikun unë skam ditë asgjë vetëm kur ka ardh shoqja e me ka treguar, se ata djemtë kanë shkuar tek ara. Kjo arë është e serbit te cilën e kemi shfrytëzuar me qira, dhe prej pas luftës se fundit ne e kemi punuar, ata djemtë shkuan unë vrapova pas tyre, ne te dy ka qenë edhe migja jonë, ky personalisht, ka tentuar qe te hyj aty dhe duke biseduar me vëllezërit

e mijë hynë me bager dhe si e ka parë se ka fjalë i njëjti është tërhequr menjëherë. Siç deklarova edhe me lartë prona ka qenë në pronësi të serbit por ne qe pas luftës se fundit ne e punojnë vazhdimisht, ku aty ka pasur shumë therra, ka qenë tokë e pa punueshme e ne e kemi berë tokë punuese, ndërsa 30 ari janë bashkë të kapur me këtë parcelë, për pjesën tjetër qe ka të bëjë nga mexha e jonë e qe vazhdon deri tek pemishtja e në drejtim të jugut asnjëherë paditësi nuk e ka punuar atë pjesë, por vetëm ne, aty janë në pyetje 16 hektar, qe kemi pas një marrëveshje gojore edhe diçka të shkruar . dhe ditën kur pretendohet të jetë shkaktuar pengesa vëllezërit e mij nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim as nuk kanë tentuar të sulmojnë askënd , duke shtuar se edhe para se të ngritje pemishte ajo pjesë është ngritur nga ne, nga se aty ka qenë there dhe mal, ku edhe kemi plehëruar të njëjtën, pasi qe kanë ardh policia na kanë thënë se nuk duhet të pengojmë nga se i njëjtit ka përfunduar garnd nga Qeveria dhe ne me nuk jemi marr me të kemi lenë të vendos gjykata. Po kemi pasur diçka me shkrim, por atë e ka migja, por edhe me fjalë jemi akorduar se nga kumbulla në drejtim të perëndimit ka qenë qe ne ta marrim ndërsa pjesën tjetër ai. Serbi na ka pyetur a don me ble, aty ka qenë prezent edhe vet axha , i cili me ka thënë pasi qe ti e ke punuar qe 20 vite kam ardh te pyes se a donë me ble. Dhe unë i kam thënë pjesën time po, ne nuk e kemi ditë se A. e ka ble as qe ka kontratë me serbin dhe për këtë e kemi kuptuar kur ka ardh policia. Ne e dijm qe A. ka qenë përfitues i një grandit dhe atë nga policia nga se ne nuk kemi pasur kontakt me të. Bagerat kanë qenë në oborrin e paditësit, arsyetimi i tyre ka qenë se po dojnë të shkojnë me poshtë të punojnë por me kërkesën qe të shkojnë nga zostojat nga pjesa qe ne e kemi punuar me parë, edhe qe nuk e kemi lejuar të vazhdoi me tutje.

Dëshmitari tjetër G. Z. ka deklaruar: me dt. 28.02.2021 kanë ardhë policia tek ne pasi qe ne e kemi ftuar bageristin për fillimin e projektit të përfituar nga M. B e cila ka qene e caktuar ne afatin prej 3 muajve, me të filluar kryerjen e punimeve për shkuarjen ne vend atëherë qe të tre djemtë e axhës kane penguar vazhdimin e rrugës deri ne vendin ku kane qene te parapara kryerja e punimeve, pas pengesës është njoftuar Stacioni Policor ne Istog, dhe pas kërkesës se policisë pronari i firmës se kryerjes se punimeve është larguar nga vendi. Aty nen prezencën tone te policisë dhe te paditurve ka ardhur edhe dy vëllezërit e mijë A. dhe A. dhe të njëjtit kane biseduar me policinë pas pese minutave të njëjtit janë sulmuar nga te paditurit dhe janë arrestuar qe të gjithë me përjashtim meje. Për pjesën e ngastrës kur është pemishtja unë tregova me larte mënyrën e pengesës ndërsa për pjesën tjetër nga gardhi e tutje pasi qe ne e kemi blere para dy viteve, te paditurit qe të tre kane filluar qe të prejne malin dhe pastaj kane vendosur një gardhe ne gjatësi prej 200 m ne lartësi përafërsisht 2 m, dhe ka qene e pamundur punimi i asaj pjese. Dhe kjo ka ndodhur diku ka viti 2019 dhe me nga atëherë ne nuk kem pasur qasje ne atë pjesë. Ne këtë pronë e kemi blerë, kemi edhe kontratë të vërtetuar te noteri mirëpo nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10 ha qe i kemi blere ne i kemi punuar vetëm 1 ha e gjysme e cila një pjese është afër shtëpisë dhe një pjese tjetër e cila është me poshtë. Para se me ble këtë pronë babai i ka pyetur po ashtu edhe agjallaret kane qene te interesuar qe fillimisht të pyeten te paditurit se a dojne qe ta blejnë apo jo. Dhe të njëjtit kane thënë se njëherë nuk kem mundësi financiare qe të blejmë, pasi qe ata kane dhënë dorëheqje ne tani e kemi blere. Ne kemi qene përfitues nga MB ne sipërfaqe prej 3 ha e 10 ari pas pengesave të shkaktuar nga te paditurit ka qene e pamundur rrespektimi i afatit dhe si pasoje e kësaj MB na kane dënuar me gjobë prej 5000 €. Mendoj për shkak se qmimi kushtues i tokës nuk ka qene aq i larte dhe kjo munde të këtë qene arsyeja qe kane pas pretendime me marre. Sipërfaqja prej 1 ka e gjysmë të cilën kanë pasur ne posedim ashte një pjese afër shtëpisë e cila përfshihet nga pika c përgjatë gardhit deri te pemishtja me gjatësi 79.60 dhe pjesa tjetër ka qene jashtë kornizës të specifikuar ne skicë e cila është me ngjyre të verdhë. Përveç kësaj sipërfaqja ku tani aktualisht është pemishte nuk kem qene duke e punuar as sipërfaqen tjetër nga gardhi e tutje deri ne përfundim për shkak se nuk kane lënë te paditurit për ta punuar atë pjesë. Unë ne atë kohe kam qene si praktikant ne PP Themelore ne Pejë ku ka qene i hapur dhe rasti për uzurpim nga prokurori i rastit jam pyetur se a kem filluar me kryerjen e punimeve dhe unë i kam thënë qe do të fillojmë shumë shpejt i njëjti me ka thënë se iu i keni të gjitha të drejtat qe ti vazhdoni punimet, po ashtu edhe nga dëgjimi në cilësi të palës të paditurin

e parë Sh. Z. i cili ka deklaruar se për pjesën që ka të bëjë nga mexha e jonë e që vazhdon deri tek pemishtja e në drejtim të jugut asnjëherë paditësi nuk e ka punuar atë pjesë,

Gjykata me rastin e vendosjes, e pas administrimit të të gjitha provave prezent në shkresat e lëndës, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 103, 113 par.1 dhe par.2 të të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), dhe nenit 480 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se pretendimet e palës paditëse janë të pabazuara.

Në bazë të nenit 103 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS), parashihet se *“personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”*. Me nenin 113 par.1 të këtij ligji është paraparë se *“nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës...”*, ndërsa në paragrafin 2 të tij ceket se *“nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi, mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore”*.

Sipas dispozitës së nenit 480, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, shprehimisht parashihet se shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, përjashtohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë dhe pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Sipas dispozitës së nenit 7, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa në dispozitën e nenit 319.1, të LPK -së, parashihet se secila palë ndërgjyqës ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Gjykata duke vendosur lidhur me kërkesë padinë e paditësit e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 7.1, 319.1, 321, 322 dhe 480, të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesë padia e paditësit është në tërësi e pabazuar për faktin se me provat e administruara, paditësi nuk e ka argumentuar pushtetin e fundit faktik të posedimit për pjesën kontestuese kush, ku, kur dhe në ç' mënyrë e ka kryer aktin e pengimit të pretenduar e që kërkohet në kuptim të dispozitës së nenit 480, të LPK-së, rrjedhimisht gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret nuk janë plotësuar të tri kushtet esenciale për institutin e pengim posedimit e që janë : kushtin parë pushtetin e fundit faktik, këtë rrethanë se paditësi nuk e ka pasur posedimin gjykata e ka vërtetuar nga dalja në teren, nga dëgjimi i dëshmitarit G. Z., i cili ka deklaruar se sipërfaqen prej 1.50 h të cilën e kem pasur në posedim është një pjese afër shtëpisë e cila përfshihet nga pika C përgjatë gardhit deri te pemishtja me gjatësi 79.60 dhe pjesa tjetër ka qene jashtë kornizës të specifikuar në skicë e cila është me ngjyre të verdhë. Përveç kësaj sipërfaqja ku tani aktualisht është pemishte nuk kem qene duke e punuar as sipërfaqen tjetër nga gardhi e tutje deri në përfundim për shkak se nuk kane lënë të paditurit për ta punuar atë pjesë. Unë në atë kohe kam qene si praktikant në Prokurorinë Themelore në Pejë ku ka qene i hapur dhe rasti për uzurpim nga prokurori i rastit jam pyetur se a kem filluar me kryerjen e punimeve dhe unë i kam thënë që do të fillojmë shumë shpejt, i njëjti me ka thënë se iu i keni të gjitha të drejtat që ti vazhdoni punimet, i cili fakte është provuar edhe me dëgjimin e të paditurit Sh. Z., i cili ka deklaruar se nga mexha e jonë e që vazhdon deri tek pemishtja e në drejtim të jugut asnjëherë paditësi nuk e ka punuar atë pjesë, nga këto del se paditësi nuk e ka pasur posedimin e fundit faktike për ngastrat 47-2, 47-1, 47.3, 47.4, si dhe pjesën e ngastrës 52-6 dhe pjesën e ngastrës 50-6. Edhe pse janë plotësuar të dy kushtet tjera mënyra e kryerjes dhe kush është kryer, si dhe afateshmërinë rezulton se padia të jetë parashtruar brenda afatit prej 30 ditë kur pretendohet të jetë kryer akti i pengim posedimit, por

ne mungese të plotësimi të kushtit të parë posedimit, kërkesëpadia e paditësit rezulton të jetë e pabazuar, sepse të akti i pengim posedimit duhet të plotësohen në mënyrë komulative që të tre kushte ligjore. Andaj, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Posedimi si term ka të bëjë me pushtetin faktik mbi send dhe nuk i referohet pushtetit juridik, ndërsa pengimi në posedim ka të bëjë me shqetësimin apo pengimin në shfrytëzimin e pushtetit faktik apo zhveshjes nga pushteti faktik dhe assesi aspektit juridik sepse këtu kemi të bëjmë me natyrën tjetër të kontestit.

Sa i përket shpenzimeve gjykata vendosi duke iu referuar dispozitës së nenit 463.1 dhe 463.2 të LPK – së.

Bazuar në nenet, 103, 113 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit mbi Pronësinë dhe të Drejtat sendore, nenit 480 të LPK-së, lidhur me nenin 142.3 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA NË ISTOG
Departamenti i përgjithshëm -Divizioni Civil C.nr. 112/21, me datë: 21.02.2022

G j y q t a r i
Shemsedin Haxhiaj

Udhëzim juridik :

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.